



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:059568

Datë: 23.10.2020

Numri i dokumentit: 01212203

**P.nr.997/16**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,** gjyqtarja e vetme gjykuese Hysnije Gashi, me zyrtaren Ligjore Albana Ujupi , në çështjen penale kundër të akuzuarit, H.H. nga fshati Jezerc, komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale pushtim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës: PP.II.nr.403-4/16 të datës 18.10.2016 së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe publik të mbajtur me datë 15.09.2020 në praninë e Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarve S.H., R.Rr., Sh.B. dhe të akuzuarit H.H. me date 15.09.2020 publikisht shpalli dhe me date 13.10.2020 përpiloi me shkrim këtë :

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

**H.H.** i lindur me ....., në fshatin ..... Komuna Ferizaj nga i ati ..... dhe e ëma, .....e gjinisë ....., i martuar, prind i 4 fëmijëve, me profesion bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **SEPSE:**

Qe nga viti 2012, e gjer me tani, ne lagjen “.....” ne fshatin ..... Komuna, Ferizaj, ne mënyrë të kundërligjshme ka pushtuar pronën e paluajtshme ne emër të dëmtuarve, S.H., R.Rr. dhe Sh.B. ne sipërfaqe prej 2376 m2 e evidentuar ne certifikatën mbi të drejtat e pronës se paluajtshme me nr.UL.....

**me të cilën kreu veprën penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe 74 të KPRK-së si dhe neni 365 të KPPK-së, të akuzuarin

## **G J Y K O N**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër /4/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej nëntëdhjetë /90/ ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e liron pronën e uzurpuar në mënyrë të paligjshme në sipërfaqe prej 2376 m<sup>2</sup> e evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr.UL.....

Nëse i akuzuari pas kalimit të afatit të caktuar nga gjykata nuk e liron pronën në fjalë dënimi më kusht do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim prej katër /4/ muajve si dhe prona do të lirohet nën kërcënimin e përmbarimit.

Te dëmtuarit: S.H., R.Rr., Sh.B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 /njëzetë/ €uro në afatin prej tridhjetë /30/ ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit.

Obligohet i akuzuari që konform neni 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 30 €uro /tridhjetë/, brenda afatit prej tridhjetë /30/ ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit

## **A r s y e t i m i**

### **Historiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.II.nr.403-4/16 të datës 18.10.2016, ka ngarkuar të akuzuarin, H.H. për veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së, i cili në fjalën përfundimtare beri përmirësimin dhe plotësimin e dispozitivit të aktakuzës ashtu që në rreshtin e tretë shtohet pas të dëmtuarit S.H. edhe R.Rr. dhe Sh.B. po ashtu në rreshtin e tretë në vend 22 ari duhet të jete 2367 m<sup>2</sup>, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 15.09.2020, në të cilën shqyrtim të pranishëm ishin prokurori i shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarit, S.H., R.Rr., Sh.B. dhe i akuzuari H.H.

### **Deklarimet e palëve në shqyrtimin gjyqësor**

I pandehuri, **H.H.** në shqyrtimin gjyqësor, me rastin e njoftimit nga gjyqtarja për drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë dhe nuk e ndien veten fajtor për veprën penale që i është vënë në barrë nga ana e prokurorisë, ndërsa në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se banon në fshatin, ..... K.Ferizaj në vendin e quajtur “.....”, dhe në vitin 2015 e ka kuptuara se djali i vëllait të tij S.H. ia kishte shitur R.Rr.t parcelën në sipërfaqe prej 22 ari e cila gjendet afër shtëpisë së tij, dhe ishte në emër të djalit të vëllait të tij S.H. të cilën parcelë ia kishte dhuruar nena e tij e ndjere, më tej ka shtuar që këtë prone e ka shfrytëzuar babi i S..... V ..... dhe pasi që kishte kuptuar se këtë parcele S ..... ia kishte shitur R.Rr. kishte biseduar me të dhe i kishte propozuar që të ia kthej të hollat ose në vende të kësaj prone ti jep një parcele tjetër.

### **Provat e prezantuara në shqyrtimin gjyqësor**

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë gjykata me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në shqyrtimin gjyqësor ka bërë paraqitjen dhe vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të ndërlidhura mes vete në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së dhe gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e ka vërtetuar në bazë të këtyre provave:

Pjesërisht nga mbrojta e të akuzuarit, nga dëshmia e të dëmtuarve S.H. R.Rr., Sh.B. dhe nga i akuzuarit H.H. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, si dhe nga provat materiale, çertifikata mbi te drejtat e pronës se paluajtshme ..... e datës 06.11.2012 Kontrata mbi shitblerjen e pasurisë se paluajtshme e datës 03.05.2012 e vërtetuar ne Gjykatën Themelore ne Ferizaj me numër VR- 2540/12 te dates me datën 03.05.2012.

Nga deponimi i te dëmtuarit –**S.H.**, është konstatuar se jeton ne Ferizaj, me pare ka jetuar ne fshatin Jezerc ne lagjen e ....., te akuzuarin H.H. e ka migje, me tej ka shtuar se posedonte pasuri tokë ne fshatin ..... ne emrin e ti te cilën e ka trashëguar nga babai i tij V..... ashtu qe ne vitin 2012 nga kjo pasuri 23 ari ia ka shitur, R.Rr. dhe Sh.B. për te cilën prone pagesën e ka marre menjëherë po ashtu edhe bartjen e ka bere ne Gjykatën Themelore ne Ferizaj. ne emër te te dëmtuarve R.Rr. dhe Sh.B..

Nga deponimi i te dëmtuarit, **R.Rr.**, është konstatuar se ne vitin 2012, e ka blerë një prone ne fshatin ..... ne vendin e quajtur “.....” ne lagjen e ..... me bashkëpronarin Sh.B. ne sipërfaqe 23 ari e 67 m nga pronari S.H. dhe për te njëjtën prone pagesën e ka bere përmes bankës, dhe ka lidhur kontrate me shtitesin S.H. me datën 03.05.2012 dhe te njëjtën e ka vërtetuar ne Gjykatën Themelore ne Ferizaj me date 03.05.2012 dhe e bartur ne emrin e tij. Sa i përket kësaj prone fillimisht kishte biseduar me S..... dhe vëllezërit e tij dhe dy vitet e para nuk ka pasur problem rreth kësaj prone ashtu qe fillimisht edhe vet i akuzuari H....., agja i S..... i kishte ndihmuar për ta rregulluar rrymën, mirëpo ne momentin kur i dëmtuari ia kishte shitur 6 ari mikut te tij N.B. dhe 2 ari e gjys Sh.B.t dhe kur kishte shkuar për ta bere ndarjen fizike te kësaj prone atëherë kishte lindur problemi me tani te akuzuarin H.H. i cili i kishte penguar qe ta bëjnë ndarjen fizike nga personi zyrtar ashtu qe i dëmtuari kishte qene i detyruar qe pa paraqet rastin ne polici, po ashtu ka shtuar se te njëjtin vit edhe një here ka tentuar qe ta bëjnë ndarjen fizike e qe edhe këtë here është penguar nga tani i akuzuari H..... i cili për ta penguar te dëmtuarin kishte vendosur rimorkio te traktorit dhe disa dërrasa dhe skele dhe se akoma nuk është lejuar qe ta shfrytëzoj pronën e tij.

Nga dëshmia e te dëmtuari **Sh.B.** është konstatuar se se bashku me R.Rr. ishi dakordur qe ta blejnë një parcele ne fshatin ..... nga pronari S.H. te cilën prone e ka paguar pemës bankës dhe la lidhur kontrate me date 03,05.2012 dhe te njëjtën kontrate e ka vërtetuar ne Gjykatën Themelore ne Ferizaj se bashku me te dëmtuarin R.Rr., po ashtu ka shtuar se fillimisht nuk ka pas ndonjë problem rreth kësaj prone mirëpo ditën kur kane shkuar qe ta

bëjnë ndarjen fizike i dëmtuari H..... i ka penguar për ti vendosur pikat me arsyetimin se pronën do te kthej dhe do te kompensoj shumen e parave te kësaj parcele, i dëmtuari ka deklaruar se akoma nuk është lejuar qe ta shfrytëzoj pronën e tij.

Nga dëshmia e dëshmitarit, **N.B.** është konstatuar se me date 10.10.2015 nga R.Rr. ka blere 6 ari toke ne lagjen e ..... ne fshatin ..... dhe ne momentin kur ne gusht te ati viti ka shkuar për pare pronën kishte dale djali i H..... dhe i kishte thënë se për këtë pronë është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore ne Gjykatë.

### **Fjala përfundimtare e palëve**

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka bere përmirësimin dhe plotësimin e dispozitivit te aktakuzës ashtu qe ne rreshtin e trete shtohet pas te dëmtuarit S.H. edhe R.Rr. dhe Sh.B. po ashtu ne rreshtin e trete ne vend 22 ari duhet te jete 2367 m2 mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të saj dhe se pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor nuk janë kontestuese faktet se pronari i parcelës kontestuese ka qene S.H. , se i njëjti këtë parcele e ka shitur dhe kontrata është vërtetuar ne ish Gjykatën Themelore ne Ferizaj ne nr.VR-2540/12 te datës, 03.05.2012 e qe blerësi ka qene R.Rr., është vërtetuar drejta pronësore mbi parcelën e lartcekur, duke kërkuar që gjykata të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Te dëmtuarit S.H., R.Rr., she Sh.B. në fjalën e tyre përfundimtare kane deklaruar se e mbështesin fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit duke shtuar se nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale, parashetrojnë kërkesën pasurore juridike

I akuzuari H.H. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nëse kane rruge pre te hyre ne këtë prone le te hynë.

### **Vlerësimi i dëshmisë së dëshmitareve dhe i provave tjera materiale**

Disa nga theksimet e dëshmitareve te dëmtuarve nuk kontestohen as nga vet i akuzuari.

Me rastin e vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarit-të dëmtuarit S.H., gjykata gjeti se kjo dëshmi ishte mjaft e saktë dhe në përputhje të plotë edhe me provat e tjera materiale të paraqitura në këtë çështje penale dhe nga kjo dëshmi u vërtetua fakti mjaft i rëndësishëm dhe i pakontestueshëm se kjo vepër penale është kryer nga i akuzuari pasi që me këtë dëshmi, por

edhe me provat e tjera materiale të paraqitura në këtë çështje penale vërtetohet se i akuzuari gjatë kohës së përmendur në dispozitiv të këtij aktgjykimi i ka penguar të dëmtuarit në mënyrë të paligjshme për ta shfrytëzuar pronën e paluajtshme të evidentuar me certifikatën e pronësisë në emër të të dëmtuarit S.H., po ashtu gjykata konstatoi se dëshmia e dëshmitarit-të dëmtuarit është në përputhje edhe me provat e tjera materiale të paraqitura në këtë çështje penale si: certifikata UL.....e datës 06,11.2912, ku është vërtetuar se e drejta pronësore mbi parcelën e lartcekur është në emër të tij po ashtu nga Kontrata mbi shitblerje e pasurisë së paluajtshme e lidhur në mes të S.H. si shitës dhe R.Rr. dhe Sh.B. si blerës e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj VR-2540/12 me datë 03.05.2012.

Po ashtu dëshmisë se e dëshmitarëve të dëmtuarve, **RR.Rr. dhe Sh.B.** Gjykata ua falë besimin për faktin se konstatuar se në vitin 2012, të dëmtuarit R..... dhe Sh.B. kanë blerë prona në fshatin ..... në vendin e quajtur “.....” në lagjen e ..... në sipërfaqe 23 ari e 67 m nga pronari S.H. dhe për të njëjtën prona pagesën e ka bërë përmes bankës, dhe ka lidhur kontratë me shëtitësin S.H. me datën 03.05.2012 dhe të njëjtën e kanë vërtetuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj me numër VR-2540/12 me datë 03.05.2012 dhe e bartur në emër të tyre. Sa i përket kësaj prona fillimisht i dëmtuari R..... kishte biseduar me S..... dhe vëllezërit e tij dhe dy vitet e para nuk ka pasur problem rreth kësaj prona ashtu që edhe vet i akuzuari H..... i kishte ndihmuar për ta rregulluar rrymën, mirëpo në momentin kur i dëmtuari ia kishte shitur 6 ari mikut të tij N.B. dhe ditën kur kishte shkuar për ta bërë ndarjen fizike të pronës atëherë kishte lindur problemi me tani të akuzuarin, H.H. i cili i kishte penguar që ta bëjnë ndarjen fizike nga personi zyrtar, ashtu që i dëmtuari kishte qenë i detyruar që pa paraqet rastin në polici, po ashtu ka shtuar se të njëjtin vit edhe një herë ka tentuar që ta bëjnë ndarjen fizike e edhe këtë herë janë penguar nga tani i akuzuari H..... i cili në atë prona kishte vendosur rimorkio të traktorit dhe disa dërrasa dhe skele dhe se të dëmtuarve akoma nuk i ka lejuar që ta shfrytëzojnë pronën e tyre.

Po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit, N.B. është konstatuar se me datë 10.10.2015 ka nga R.Rr. i ka blerë 6 ari toke në lagjen e ..... në fshatin ..... dhe dhe në momentin kur në gusht të atij viti ka shkuar për prona kishte dale djali i H. .... dhe i kishte thënë se për këtë prona është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore në Gjykatë.

### **Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit**

Gjykata me një vëmendje të posaçme dhe kujdes të shtuar e ka vlerësuar dhe analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo pretendimin e të akuzuarit se ai nuk e ka pushtuar pronën dhe nuk e ka kryer këtë vepër penale gjykata e vlerësoi si jo reale dhe jo të besueshëm ngase një pretendim i tillë nuk mund të vërtetohet me asnjë provë bindëse, reale dhe të pakontestueshme dhe për më tepër ky pretendim është në kundërtënie të plotë me dëshminë e dëshmitarit-të dëmtuarve, S.H., R.Rr. dhe Sh.B..

Se i akuzuari e ka uzurpuar në mënyrë të paligjshme pronën kontestuese vërtetohet edhe nga dëshmia e të akuzuarit e dhënë në shqyrtimin gjyqësor në të cilën ai e ka pranuar se i ka penguar te dëmtuarit te shfrytëzojnë pronën e pa luajtshme dhe se nuk ka arritur qe te prezantoj gjykatës asnjë prove se prona është ne emër te ti . Andaj duke u bazuar në provat dhe të gjeturat e tjera, gjykata mbrojtjes së të akuzuarit nuk i shprehi besimin e plotë pasi që një deklaram i tillë nuk mund të provohej me asnjë prove bindëse, reale dhe të pakontestueshme dhe si i tillë është i orientuar në fshehjen e veprimeve inkriminuese të të akuzuarit dhe në zvogëlimin e përgjegjësisë së tij penale.

### **Të gjeturat e gjykatës, matja dhe shqiptimi i dënimit**

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, se nuk rezulton të jetë dënuar më parë për ndonjë vepër penale, moshën e tij , faktin se i akuzuari është baba i katër fëmijëve, respektivisht mbajtës i familjes, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në

proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

**Kërkesa pasurore-juridike dhe shpenzimet e procedurës penale.**

Te dëmtuarit S.H. R.Rr., Sh.B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par. 2, nenpar. 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL,**  
**P.nr.994/16 datë 13.10.2020**

**Zyrtare ligjore**

Albana Ujupi

**Gjyqtarja**

Hysnije Gashi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.